



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

## Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-35733 /23

Klinë, dt: 13.10 /23

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VIII e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 06.09.2023, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti të gjithë anëtarët e Komitetit, OSBE-në, drejtorë të drejtorive dhe gjithë të pranishmit.

Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i draft-buxhetit te komunës së Klinës për vitin 2024 dhe projekzionet për vitet 2025-2026 (ref. Drejt. Fin.),
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri ( ref. Drejt. Fin.),
5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin korrik-gusht 2023,
6. Të ndryshme.

**Fadil Gashi, kryesues:** Atëherë, nëse pajtoheni, ne kishim filluar sot prej pushimit që e kemi pasur. Unë po ju falënderoj për prezencë, jemi gjashtë prej shtatë anëtarëve të KPF-së; Valmire Krasniqi ka konfirmuar që nuk është në Kosovë dhe të tjerët jemi prezent, që konstatoj që mund të vazhdojmë me punën e KPF-së.

Kjo pjesa tjetër për rend të ditës është veç një kërkesë shtesë, është prej fshatit Sferkë, realisht është e një lagjeje, nëse pajtoheni që ta vëmë në rend të ditës, unë veç po ju jap një propozim që nëse e vëmë në rend të ditës, ne të ja vejmë Drejtorisë së Urbanizmit të merret me këtë çështje, me pronën e me parcelën e me defiminimin e saktë të kërkesës, se nuk është sikur fshati sikur lagija, prandaj i do disa meremetime. Po, urdhëro, Azdren?

**Azdren Ramadani:** Përshëndetje për të gjithë! Unë së pari e kisha përkrahur gjithë fshatin që t'i jepet mundësia atyre për shfrytëzimin e tyre, që e kanë për çdo nevojë personale apo familjare.

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, Azdren, dikush tjetër? Urdhëro, Tunë Deda?

**Tunë Deda:** Po, kryesues, përshëndetje për të gjithë! Kërkesa është me vend dhe të gjithë pajtohem, njëherësh kërkojmë që gjatë ndërtimit të ndërtohet me bashkëfinancim 30% nga komuniteti e 70% nga Kuvendi i Komunës.

**Fadil Gashi, kryesues:** Nëse ju pajtoheni, ndoshta e kishim futur në rend të ditës, pastaj e kishim elaboruar pak më shumë. Urdhëro, Zafer Gashi?

**Zafer Gashi:** Si Lëvizje Vetëvendosje e grupit parlamentar, kam ardhur si zëvendësim i anëtares sonë, Valmire Krasniqi, e cila mungon sot me arsy. Kemi kërkesë që të merren nënshkrimet nga asamblistët për një seancë të jashtëzakonshme të kuvendit komunal, lidhur me vendimin e gjykatës së apelit në Prishtinë për një fitore që e ka arritur komuna e Klinës më së pari, e cila ka qenë e paditur nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe qytetarët e Klinës, pra, të diskutohet përrnjehën e mëtutjeshme dhe pasojat që kanë ndodhur në diskutimet që janë bërë ndër vite përkëtë çështje. Mendoj që është në interes të madh të publikut, pret publiku që të bisedojmë përkëtë pikë të rendit të ditës. Kam biseduar me kryetarin e grupit parlamentar të PDK-së, Esat Racin dhe Adem Limanin të LDK-së që t'i marri nënshkrimet, nuk janë përgjigjur në mënyrë definitive, deri të hënën ju kisha lutar nëse ka nevojë përkonsultime, anëtarët këtu që janë pjesë e objekteve me kryetarin e grupit parlamentar dhe të bisedojmë edhe të shihet mundësia që kjo të futet në rend të ditës ose të japim nënshkrimet për seancën e jashtëzakonshme. Nëse kjo nuk kalon, atëherë kërkojmë që kjo të futet në rend të ditës si pikë e rregullt në seancën e datës 22 që të mbahet një interpellancë me kryetarin e komunës lidhur me vendimin e fundit të gjykatës së apelit për ndalimin e fabrikës së cimentos.

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, Zafer! Ne nuk mundemi as në komitet as në kuvend me marr ndonjë votim përmbledhje të nënshkrimeve në vullnet të partive politike, po është në vullnet të subjekteve a duan t'i grumbullojnë nënshkrimet, edhe nëse grumbullohen nënshkrimet

e keni problem për ta udhëhequr seancën , unë nga sot deri më 15-tin nuk jam këtu, se grumbullimi i nënshkrimeve dhe thirrja e seancës së jashtëzakonshme i ka tri ditë pune. Po realisht nëse ju e vlerësoni, kushdo prej anëtarëve të kuvendit, ne, me 22 e kemi seancën e kuvendit, e kemi seancën e rregullt dhe ju mund të bëni kërkesë me shkrim për ta futur në rend të ditës në seancë të rregullt, nëse jemi përpara seancës, ka alternativa të mjaftueshme. Po, urdhëro, Zaf ?

**Zafer Gashi:** Një sqarim: Kërkesën ne mund ta bëjmë në drejtim të kryesuesit të asamblesë komunale, që të futet në rend të ditës në mbledhjen e rregullt, a mund ta bëjmë këtë kërkesë?

**Fadil Gashi, kryesues:** Absolut, ju, po edhe secili anëtar ka të drejtën të ju drejtohet kryesuesit me një kërkesë, kjo nuk dmth se kalon në seancë. Për atë ne e miratojmë rendin e ditës, ne e bëjmë një propozim prej zyrës tij bashkë me kryetarin, ne, zakonisht në seancë e miratojmë rendin e ditës. Atëherë edhe njëherë, kush është për miratim të rendit të ditës bashkë me kërkesën që e patëm ?

**Me 6 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua rendi i ditës.**

**Pika 1. Arsyetimi i mungesave.**

**Fadil Gashi, kryesues:** Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës, te arsyetimi veç e thash se Valmira mungon, tjerët jemi prezent.

**Pika 2 . Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.**

**Fadil Gashi, kryesues:** Nëse ka dikush rrëth procesverbalit të seancës së kaluar, a ka dikush ndonjë vërejte, ndonjë sugjerim? Nëse s'ka, kush është për?

**Me 6 vota PËR,asnjë kundër, u miratua procesverbal i seancës së kaluar.**

**Pika 3. Shqyrtimi i draft-buxhetit te komunës së Klinës për vitin 2024 dhe projekzionet për vitet 2025-2026 (ref. Drejt. Fin).**

**Fadil Gashi, kryesues:** Unë po e falënderoj edhe drejtorin për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim që e kemi prezent këtu, z. Enver Berisha, dhe po ja kaloj fjalën.

**Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Faleminderit, kryesues, përshëndetje për anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa! Realisht që disa kohë tashmë kjo është temë e debatit, çështja e kornizës afatmesme buxhetore. Ne, siç e dini ju, kemi bërë përpjekje që këtë projektbuxhet ta vëmë në diskutim publik dhe në krejt territorin e komunës sonë, nëpër lokalitete të caktuara dhe po ashtu, përveç angazhimeve në terren, ne e kemi ftuar edhe në kuadër të komunës, bizneseve, kemi ftuar OJQ-të, gratë, rininë, që njëfarë forme, secili segment i jetës me dhanë kontributin e vet në kuadër të këtij projektbuxheti për vitin 2024-2026.

Projektbuxheti për vitin 2024 është 14.648.717.00 euro. Në kuadër të këtij buxheti, dmth janë Pagat dhe Mëditjet 7.936.857.00 euro; mandej Mallra dhe Shërbime me 1.710.000.00 euro; janë Shërbimet Komunale me 250.000.00 euro; Subvencionet janë 600.000.00 euro; dhe Shpenzimet Kapitale që janë total për të gjitha drejtoritë, janë 4.151.860.00 euro; dhe këto janë të shpërndara në kuadër të drejtorive veç e veç. Drejtoria e Urbanizmit është me 2.961.860.00 euro; Drejtoria e Bujqësisë është me 180.000.00 euro; Infrastruktura Rrugore dmth, edhe kjo në njëfarë forme hyn në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit, Drejtorisë së Bujqësisë, etj., që janë mirëmbajtje, shpenzime të rrugëve, etj., me 455.000.00 euro; është Shëndetësia me 225.000.00 euro; Inspeksioni me 30.000.00 euro; Administrata me 65.000.00 euro; Kultura 55.000.000 euro; dhe e fundit; Arsimi është me 210.000.00 euro. Dmth ai projektbuxhet është i kategorizuar me shpërndarje nëpër Drejtori në kuadër të këtyre shifrave që unë i ndjekë dhe po ashtu, krejt kjo është në 43 projekte që janë të shpërndara në tërë territorin e komunës. Unë besoj që ky buxhet edhe pse është i rritur në krahasim me 2023-tën, nuk mjafton me i realizuar dhe me i përmbushur të gjitha kërkeshat dhe nevojat e qytetarëve që janë, por, ne si ekzekutiv bashkë edhe me kryetarin, me opinionin që e kemi marr nga terreni, kemi bërë përpjekje që janë më të domosdoshme dhe kemi bërë përpjekje po ashtu, që të përfshihet i tërë territori i komunës sonë. Dmth, pa anime të asnjë lloj natyre, përveç kësaj dmth është pjesa që ne e kemi planifikuar edhe për 2025-2026. Projektbuxheti për këto dy vite normal që është dukshëm më i madh sesa i 2024-ës , dmth nga 14.600.000.00 për 2024 , për 2025 planifikohet 15.405.946.00 euro, ndërsa në 2026-tën planifikohet me qenë buxheti 16.163.056.00 euro, me 9.000.000.00 vlera bukur dalluese, por, po shpresojmë se ky planifikim, ky projektbuxhet do të jetë në interesin dhe në kërkeshat e qytetarëve që ata kanë shfaqur në vazhdimësi dhe të planifikimeve tonë si komunë që kemi menduar që janë të domosdoshme të realizohen, faleminderit!

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, drejtor! Po, urdhëro, Tunë Deda?

**Tunë Deda:** Faleminderit shumë, drejtor, për këtë informacion! Unë e kam parë me vëmendje projektin për vitin e ardhshëm 2024 dhe kërkoj që të parashihet në këtë buxhet ndërtimi i trotuarit nga Klina deri në Zllakuqan. Është një pjesë e ndërtuar, po atij gjithçka mund t'i thuash, po trotuar s'mund t'i thuash, se është i ndërtuar dobët edhe të parashihet ndërtimi i trotuarit nga Klina deri në Jagodë. E kam edhe një kërkeshë që mua më ra në sy që e kam parë se nuk është në rregull: të shtohet buxheti për bujqësi nga 150.000.00 a sa është e paraparë aty, të bëhet 400.000.00 euro, dhe të hapen kanalet për ujitje edhe pendët, që deri në vitin 2025 mos të mbetet asnjë pëllëmbë tokë pa u ujitur. Kjo kërkeshë e imja që do ta kërkoj edhe në asamble, nga asamblistët, të përfshihet në buxhet, kaq!

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, Tunë, dikush tjetër? Po, urdhëro, Azdren?

**Azdren Ramadani:** Faleminderit, kryesues! Te ndërtimi i rrugës së infrastrukturës nëntokësore, ku është Këpuz-Qeskovë, që janë të ndara 15.000.00, unë kisha kërkuar që të rritet në shifrën 50.000.00 se janë dy fshatra, faleminderit!

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, Azdren! Atëherë a jeni për ta rekomanduar për kuvend? Kush është për?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-buxhetit të Komunës së Klinës për vitin 2024, me 6 vota PËR, rekomandoi që i njëjti së bashku me propozimet e dhëna të kalojë për shqyrtim dhe miratim në kuvend.**

**4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri ( ref. Drejt. Fin.).**

**Fadil Gashi, kryesues:** Unë ja kisha dhënë fjalën drejtorit për prezantimet dhe pastaj kishim hapur debat!

**Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Faleminderit, kryesues! E para është kërkesa për rritje të buxhetit për serra, fazë e dytë, siç e dini, përveç fazës së parë që i kemi ndarë 100 serra, kemi shpallur edhe një mundësi të dytë për dhënien edhe të 100 serrave tjera dhe n ‘këtë fazën e dytë, numri i serrave është 101, dmth një është më tepër, për shkak se dy konkurrentët e fundit kanë qenë në vlerësim të barabartë dhe nuk e kemi ndarë, kështu që, kërkesën besoj e keni marr me kohë. Nuk besoj që ka nevojë të shtojë diçka më shumë, për shkak se këto janë së ndërtuari, janë ndarë.

Ndërsa, kërkesa e dytë është për një shpenzim të një vlere që është bërë më herët, por në fakt pagesa nuk është ekzekutuar dhe kjo shumë prej 68.922.00 euro ka shkuar më herët në bartje, por për shkak se është dashur kod i ri edhe për këtë shumë, për faktin se sheshi ka kaluar një kohë dhe ka rënë ai kodi i vjetër që ka qenë, tash ne duhet ta aprovojmë si vlerë të veçantë me kod të ri , shumën prej 68.922.00 euro, për sheshin “ Mujë Krasniqi”.

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, drejtor, është e çartë kërkesa edhe për bartje edhe ndërrimi i kodeve. A ka dikush, po, urdhëro, Zafer Gashi?

**Zafer Gashi:** Faleminderit, kryesues! Me të vërtetë materialin nuk e kam marr po tash e mora. Faleminderit drejtorit të Financave, serra është shumë e mirëpritur, besoj që do të realizohet pa probleme edhe është në realizim e sipër me sa e kuptova. Nuk kam nevojë ndonjë si të them, fajësim ose diçka, lidhur me këtë ndarjen e re për 68.000.00 euro, por, drejtor unë e di që kjo ka

përfunduar qysh në ato qeverisjet e mëhershme, nuk dyshoj që ka qenë kontribut i pavlefshëm, por, ne do ta votojmë kur të vjen sigurisht, por sugjerimet tona janë... A janë punë të pakryera të partisë apo të pakryera për punën që është bërë? Nëse është bërë puna, është bërë prishja, atëherë ekzistojnë disa ligje që duhet të sanksionohet, kjo është ajo, nëse është bërë puna dhe nuk është bërë mirë. Tash na kanë dalë problemi te prishja e strukturës aty nëpër shesh, ajo duhet të ketë njëfarë garancioni. Është mirë nëse është faji i operatorit, jo faji i komunës se s'ke qare se të shkon kamata më e madhe, vetëm këtë ta sqaroni, sigurisht edhe në seancë do ta bëjmë këtë pyetje për sqarim për publikun që, përsë duhet t'i japim këto para për diçka që mendojmë se është e kryer? Faleminderit!

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, po, urdhëro, drejtor?

**Enver Berisha, drejtor i DUMM:** Përvendetje, kryesues dhe ju anëtarë të komisionit! Sa për informim, ky borxh i trashëguar prej ndërtimit të sheshit është diku i viteve të kaluara, është bartur vit pas viti, për shkak që deri në vitin 2023 në muajin e njëmbëdhjetë ka sigurim, dmth ka qenë një sigurim dyvjeçar. Për atë kam kërkuar prej operatorit që edhe këtë vit që ka pasur te sheshi të ndërhyjë, ju veç e keni parë, kanë ndërhyrë vit për vit në ngjyrë, kanë ndërhyrë në kubëza të gurëve dhe te çdo defekt që e kam vërejtur, kam kërkuar prej faktorit që brenda sigurimit ai ta rregullojë. Ai ka vepruar dhe për shumën e cila kërkohet të krijohet kod i ri ne e kemi trashëguar si borxh, për shkak që ka qenë i mbuluar me sigurim dhe tash përfundon afati i sigurimit. Pranimi teknik është bërë para dy viteve, nuk shkruan në pranim teknik se ka ndonjë vërejtje, andaj ne jemi të obliguar t'ia paguajmë shumën e cila ka qenë borxh i trashëguar, me kusht që mos të bëhet me përmbarues. Kështu e kam marr informacionin, kështu po ua jap edhe juve, kemi kalkuluar disa herë që a është shuma e caktuar në krahasim me kontratën, mirëpo në bashkëpunim me financa na del që kjo shumë është borxh i papaguar, faleminderit!

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, po, Tunë Deda?

**Tunë Deda:** Mënyra qysh është punuar edhe këto kubëza s'kanë pasur kurrë rahati, këto kubëza duhet të hiqen gjitha përsëdyti komplet, me u shtruar një shtresë e betonit komplet sa është e paraparë dhe kubëzat me u shtruar përmbi shtresë të betonit, për arsyen se këtu e ka një pjesë beton në mes edhe tjerat pjesë i ka rëndë, ato flenë. Kështu që, për këto para me u paguar edhe unë jam për me ja paguar njërit që e ka kryer punën, po duhet me dhënë përgjegjësi dikush, kush e ka mbaruar këtë punë, se kjo punë është jo e përbërë mirë. Ju dilni sot këqyrni kubëzat, nëse dikush thotë që këto kubëza janë në rregull, pajtohem. Kërkoi falje prej gjithëve, por, punë e kryer mirë kjo nuk është!

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, po, drejtor?

**Enver Berisha, drejtor i DUMM:** Inderuar, unë kam ndërhyrë disa herë, i kam bërë presion operatorit që punimet kanë pësuar dëme brenda sigurimit, ai nuk është përgjigjur sepse thotë s'ju keni përbajtur rregullave që ne kemi kërkuar. Rregull ka qenë në kontratë, p.sh., që mos të

hynë makinat e rënda, gjegjësisht kanë pasur të hyjnë në shesh vetëm policia, ndihma e parë dhe zjarrfikësit. M’i kanë sjellë me foto kamionët me 12 tone, kështu që, ne jemi përgjegjës që kontrata nuk është përfillur siç ka qenë, kështu që, ju lutem kisha pasur kërkesë që këtë borxh t’ia paguajmë, sepse na i merr ai ashtu kështu.

**Tunë Deda:** Kërkoj falje, drejtor, është dashur me e paraparë edhe projekti që këtu duhet me hyrë edhe kamioni, se ka m'u ndërtuar ndonjë objekt edhe kamioni s'ka qare pa hyrë. Lejohet të hyjë në krejt boten e jo veç në Klinë, por projekti ka qenë i dështuar, se e njëjta punë është bërë në Lezhë, unë jetoj, edhe bien kamionët me çimento se është fabrika e blloqeve. Këtu është fajtor numër një projekti, ai projektuesi që e ka projektuar edhe ai duhet të jap përgjegjësi, sipas meje.

**Fadil Gashi, kryesues:** Është mirë ne t’i kryejmë obligimet nëse ne jemi borxhlinj, ne mos me qenë borxhlinj me na ardhur përmbaruesit, pjesën tjetër unë pajtoi me gjitha, se aty ka qenë një komision që ka bërë një pranim teknik, ka pasur një menaxher të projektit, se lidhshmëria e zyrtarëve dhe institucionit janë pjesë e veçantë. A ka dikush tjetër?

**Zafer Gashi:** A mundet tash drejtori të marr masa, që tash mos të futen automjetet e rënda, mos të përsëriten defektet e tillë të sheshit nëpër vende të caktuara? Unë asamblistin e aleancës e përkrahi që tha me i vënë kubëzat.

**Fadil Gashi, kryesues:** Shiko, ne, edhe sot me ndal transportin e rëndë nuk mundemi, se ajo shkon e merr një leje të veçantë, për me bërë një ndërtim. Pra, ne mund ta ndalim transportin e rëndë, por në raste të veçanta e bën kërkesën edhe je i obliguar të ja lejosh. Po, urdhëro, Azdren?

**Azdren Ramadani:** Kjo punë është votuar këtu nga kuvendi, edhe atëherë ka qenë për t'u votuar që mos të futen me makina të rënda. Kur i kanë futur tash është dëmtuar, normal që s'mundet t'i jap garanci kurrikush dhe s'kemi ç'të bëjmë.

**Fadil Gashi, kryesues:** A ka dikush tjetër? Nëse s'ka, kush është për?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrimit të dy propozim-vendimeve të lartpërmendura, me 6 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekandoi që të njëjtat të kalojnë për shqyrtim dhe miratim në kuvend.**

## 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin korrik-gusht 2023.

### Kërkesa 1.

Parashtruesi i kërkesës, z. Gievdet Fejza Prebreza, Drenoc, i cili thekson: Po e dorëzoj këtë kërkesë për marrjen në shfrytëzim të parcelës me numër P-71011030-00116-0, Zona

Kadastrale Drenoc e cila gjendet para parcelës time me numër : P-71011030-00117-3, parcelë në të cilën unë kam dy shtëpitë në të cilat banoj me familje. Parcëla gjendet para parcelës time në komplet gjatësinë, andaj më duhet shfrytëzimi i saj për pastrim nga shkurret, mbjellje të drunjëve dekorativ, hapësirë gjelbëruese. Shprehëm i gatshëm që në rast të dhënies në shfrytëzim të kësaj parcele, do jem i gatshëm të paguaj taksat sipas ligjeve në fuqi dhe ta kthej prapë kurdo që kërkohet. Po ashtu, zotohem në mirëmbajtjen dhe mosdëmtim të mjedisit brenda kësaj parcele.

**Fadil Gashi, kryesues:** Tash unë po ju njoftoj juve që ne e kemi pasur po të njëjtën kërkësë edhe njëherë edhe ja kemi kthyer përgjigjen të njëjtit më datë 13 janar 2023 dhe kështu është përgjigja: KPF në bashkëpunim me Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, ka bërë verifikimin e listës së pronave të cilat parashihen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023, dhe ka vërtetuar se parcëla me numër si i referohet, zona kadastrale, Drenoc, me sipërfaqe kaq, nuk ekziston në atë listë. Prandaj, bazuar në Ligjin kaq dhe në Rregulloren kaq për përcaktimin e procedurave dhe të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim pronës së paluajtshme të komunës parcelën në fjalë, nuk mund të jepet në shfrytëzim gjatë vitit 2023 sepse nuk është në atë listën që e ka planifikuar komuna.

Ju e dini se tash jemi të obliguar me i pasur parcelat të cilat dëshiron t'i jap komuna në shfrytëzim ose në këmbim, prandaj e ka marr një përgjigje. A ka dikush, urdhëro, Azdren?

**Azdren Ramadani:** Faleminderit, kryesues, edhe unë kam biseduar me parashtruesin e kërkësës edhe arsyja që ai po e kérkon për t'ia dhënë në shfrytëzim atë parcelë është arsyja veç për shkak të mirëmbajtjes. Do të thotë që asajde e kanë bërë sikur depo mbeturinash duke i hedhur gjithë, pra, kjo ka qenë arsyja që e ka bërë këtë kërkësë. Ai më tha që edhe me foto me gjitha i sjelli po nuk i paska sjell këtu, kjo kërkësë mundet p.sh., që të kalojë në kuvend, kështu që e kishim diskutuar prapë edhe ja kishim bashkangjitur edhe tjerat.

**Fadil Gashi, kryesues:** Unë po besoj ashtu si ti edhe si gjithë të tjerët, asnjëri nuk jemi duke e kundërshtuar, po tash ne jemi të obliguar me Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Publike, lista që e ka dhënë bëhet publike për secilën pronë që mendon komuna. Nëse komuna sot vendos ta jap këtë pronë, duhet të planifikohet tash në 2024-tën në listë, se për 2023-tën e ka përfunduar, nuk ka sjellë listë. A ka dikush tjetër?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkësës së parashtruar nga z. Gjevdet Fejza Prebreza, për dhënie në shfrytëzim të hapësirës e cila gjendet afër shtëpisë së tij në fshatin Drenoc, vërtetoi se po i njëjti kishte bërë kërkësën e njëjtë më datë 13.12.2022, ku me këtë rast kërkesa është shqyrtuar nga KPF, më datë 13.01.2023 dhe ka marr përgjigjen si në vijim: KPF në bashkëpunim me Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, ka bërë verifikimin e listës së pronave të cilat do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023 dhe ka vërtetuar se parcëla me numër P-71011030-00116-0, Zona Kadastrale Drenoc me sipërfaqe prej 3503m<sup>2</sup> nuk ekziston në listën e pronave të cilat parashihen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023, andaj bazuar në Ligjin Nr.06/L-092 dhe Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, parcëla në fjalë nuk mund të jepet në shfrytëzim gjatë**

vitit 2023. Andaj e njëjta përgjigje vlen edhe me rastin e parashtrimit të kërkesës së dytë.

## Kërkesa 2.

Parashtruesi i kërkesës, z. Elmi Dushi, Klinë.

Kërkon nga Komuna e Klinës që të ju ndihmojë në ndërtimin e dy ashensorëve në objektin e ndërtuar pas luftës ku jetojnë 24 familje në objektin banesor “Rafi” në Klinë.

**Fadil Gashi, kryesues:** Dorën në zemër, unë jam me krejt qenien time për t’ju ndihmuar, po, urdhëro, drejtor?

**Enver Berisha, drejtor i DUMM:** Unë jam dakord edhe e ndjej shqetësimin e tyre, i kuptoj banorët, mirëpo problemi është që ndërtesa nuk është komunale, është private...

**Fadil Gashi, kryesues:** Në koncesion ka qenë, 33% e ka komuna.

**Enver Berisha, drejtor i DUMM:** E atëherë qenka pak më lehtë, duhet me këqyr bazën ligjore, me gjetur me participim është fjala, sepse mund të hyj në bashkëpunim mes kryetarit dhe banorëve edhe me gjetur formën që mund të ju ndihmohet atyre banorëve. E gjejmë bazën ligjore pak më lehtë sepse kur është krejt private është problem pak.

**Tunë Deda:** Kryesues edhe njëherë, prapë dua ta them një mendim timin, edhe aty është bërë gabim nga ana e atij që e ka dhënë lejen për ndërtim, sepse objekti është gjashtë kate, edhe atëherë është dashur të thirret dikush përgjegjës pse ju ka dhënë leja? Se ai punëtori i komunës që ka qenë e ka ditur që objekti gjashtë kate, pa ashensor nuk bën, është me ligj. Mirëpo, tash pas kërkesës së tyre unë pajtohem prapë, ata ta tubojnë një shumë parash prej 30% dhe 70% komuna edhe me jua ndërtuar listin atyre qytetarëve, nëse janë të gatshëm.

**Fadil Gashi, kryesues:** Po, urdhëro, drejtor?

**Enver Berisha, drejtor i DUMM:** E shoh shpesh që drejtohesh se kush ja ka dhënë lejen, më dëgjo pak: ja ka dhënë lejen organi kompetent. Ai projekt e ka pasur një inxhinier përgjegjës komplet për hartimin dhe rregullimin e planit dhe ai parashev a ka nevojë për ashensor apo s’ka nevojë, nuk është organi komunal i cili përcakton kriteret e ndërtimit sepse është përgjegjës stafi i inxhinierisë. A ka shtyllën e vogël apo të madhe, ajo është çështje e inxhinierisë. Kështu që, inxhinieri e ka paraparë dhe e kemi pranuar, nuk e di kur ka ndodhur ajo, por kështu është.

**Tunë Deda:** Më vjen keq, drejtor, nuk është ashtu sepse për atë janë inxhinierët e komunës, me e paraparë. Unë e kam ndërtuar objektin tim privat në Shëngjin, nuk ke guxuar me gjuajt një lopatë beton pa ardhur inxhinieri i komunës me paraparë a është i ndërlidhur mirë hekuri, nuk ke guxuar, e ke pasur të kotë atë punë. Kush ka qenë atëherë është dashur me e paraparë se objekti gjashtë kate pa ashensor nuk lejohet.

**Fadil Gashi, kryesues:** A ka dikush tjetër? Kush është për?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kérkesës së parashtruar nga z. Elmi Dushi, me 6 vota PËR, rekomandoi që kérkesa të dërgohet për shqyrtim në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.**

### **Kérkesa 3.**

Kérkesë nga z. Nue Kitaj nga fshati Krushevë e Madhe, Komuna Klinë, me anë të së cilës kérkon nga komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve, nga vërshimet e fundit, që t'i ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme lidhur me dëmshpërbimin material finansiar, me rastin e shkaktimit të dëmit, si pasojë e djegies nga rryma. Thekson se, më datë 02.06.2023, me rastin e shkaktimit të dëmit, si pasojë e rrymës, është shkaktuar dëm i konsiderueshëm material, ku rryma e cila ka depërtuar brenda shtëpisë ka djegur të gjitha gjësendet materiale, pajisjet elektronike, dhe gjësende të tjera nga ekonomia familjar, brenda shtëpisë, duke bërë të pa banueshme. Të gjitha këto dëme të lartëzakura, kalojnë shumën mbi 7.000 euro, fakt që provohet dhe vërtetohet edhe me daljen e komisionit komunal në vendin e ngjarjes dhe foto dokumentacionit që gjendet në kérkesë.

**Fadil Gashi, kryesues:** Urdhëro, Tunë?

**Tunë Deda:** Po, kryesues, unë mendoj që këtu është mirë të parashihet dhe t'i ndihmohet diçka nga zyra e kryetarit sepse ndoshta ka mundësi, këtij ju ka djegur pjesa e shtëpisë, po unë i bëj atij propozim që t'i bëjë padi në gjykatë KEDS-it për dëmshpërbimin, se KEDS-i është i obliguar gjitha dëmet që i bën, pse ata kanë qenë fajtorë, për t'ia paguar.

**Fadil Gashi, kryesues:** Po, për këtë duhet të ketë një raport që ka dalë një komision dhe i ka bërë vlerësimin edhe shkaqet e zjarrit. Raportin e bën policia, shërbimi i zjarrfikësve..ata (KEDS-i) janë të obliguar të ja kompensojnë. A ka dikush ndonjë propozim?

**Tunë Deda:** Me formuar një komision nga komuna, të shkojnë dhe të ja vlerësojnë dëmin edhe të ja bashkëngjitin atë vlerësim të dëmit në gjykatë, ai me ja bërë paditë KEDS-it.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kérkesës së parashtruar nga z. Nue Zef Kitaj, me 6 vota PËR, rekomandoi që kérkesa të dërgohet për shqyrtim në komisionin komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitetë natyrore dhe fatkeqësitetë e tjera.**

### **Pika 10. Të ndryshme.**

Kërkesë nga banorët e fshatit Sferkë të cilët kërkojnë ndarjen e një parcele në hapësirë prej 5 ari nga parcela P-71010072-00558-0 Zona Kadastrale Sferkë për ndërtimin e një objekti i cili do të shërbente për nevojat e bashkëfshatarëve.

**Fadil Gashi, kryesues:** Në të ndryshme e kemi kërkesën e fshatit Sferkë. Ne po ja kalojmë Drejtorisë së Urbanizmit edhe tash le të merret me të sepse në fund të fundit kjo Drejtori ka me marr përgjegjësi për t'ia dhënë lejen e ndërtimit. A ka dikush tjetër?

**Tunë Deda:** Po e përsëris edhe një herë, kryesues, çdo fshat që është në gjendje t'i tubojë 30% të mjeteve, ata e kanë të drejtën të kërkojnë prej kuvendit komunal për t'iu ndihmuar, kjo është e ligjshme, për atë shkojnë të hollat 400.000.00 euro te zyra e kryetarit.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga banorët e fshatit Sferkë, me 6 vota PËR, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

**Fadil Gashi, kryesues:** A ka dikush tjetër?

Atëherë me kaq po e mbylli mbledhjen e KPF-së duke ju falënderuar për pjesëmarrje!  
Shihemi në takimin e radhës!

Procesmbajtësja,  
Monika Palushi



KRYESUESI,  
Fadil Gashi